



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN) më datë **16.10.2014** realizoi vizitë për rikontroll në Burgun Prilep. Këtë vizitë MPN-ja e zbatoi i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e jashtëm të Shoqatës së ForezNIKëve të Institutit për Mjekësi Ligjore, në bazë të nënshkrimit paraprak të Marrëveshjes për bashkëpunim.

Kjo vizitë pason pas vizitës së rregullt, të cilën e MPN-ja e realizoi në Burgun Prilep më datë 01.10.2012, për çka përgatiti raport të veçantë me konstatime dhe rekomandime përkatëse, të cilat iu dërguan Drejtorisë së Burgut Prilep dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i vizitës për rikontroll është ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e veçantë të MPN-së nga viti 2012 dhe identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

MPN-ja zbatoi vizitë të targetuar, e cila fokusohet në disa konstatime negative nga raporti i veçantë i datës 01.10.2012 dhe kontrollin mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e gjendjeve dhe eliminimin e rreziqeve, të cilët do të mund të çonin deri në torturë ose lloje të tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Gjatë vizitës për rikontroll, MPN-ja zhvilloi bisedë me një numër të madh të personave të dënuar në të gjitha repartet, me ç'rast sjellja e Sektorit të Sigurimit u vlerësua si korrekt dhe pjesa më e madhe e personave të dënuar dhe të paraburgosur ishin të kënaqur nga sjellja e Shërbimit të Sigurimit, si dhe nga Sektori për Risocializim dhe drejtori i Institucionit.

Gjendja me aktivitetet produktive dhe angazhimin me punë të personave të Repartit të Mbyllur, si dhe personave të paraburgosur nuk ka ndryshuar. Nga inspektimi i ambienteve në Repartin e Paraburgimit u konstatua se ambientet e njëjta pjesërisht ishin rinovuar (të njëjtët ishin bojatisur), në krevate ishin vendosur dyshekë të rinj, personat e paraburgosur përdornin shtroje personale, ambienti dukej i pastër dhe i rregullt. Personat e paraburgosur ishin të kënaqur nga ushqimi të cilin e marrin në burg.

Gjatë vizitës për rikontroll në Repartin e Pranimit, MPN-ja konstatoi se dyert e ambienteve akoma janë të dëmtuara, e që mund të çojë deri në ngrohje të pamjaftueshme të dhomave gjatë periudhës së dimrit. Gjatë inspektimit të një dhome u konstatua se në të njëjtën ishte vendosur një tavolinë me aparat televiziv. Në Repartin e Pranimit kishte persona të vendosur të transferuar nga ENK "Idrizovë" dhe një person i dënuar i sapo pranuar. MPN-ja edhe një herë shprehu shqetësim për mundësinë e përhapjes së infeksionit kriminogjen. Personi i sapo pranuar ceku se gjatë pranimit i është bërë në kohë kontrolli nga mjeku, ndërsa kontrolli mjekësor i ishte bërë në prezencë të personit zyrtar të Sektorit të Sigurimit. Në pjesën e mbrojtjes shëndetësore dhe ushqimit, personat e këtij reparti nuk patën ankesa.

U konstatua se ambienti për avokatë dhe vizita me familjet është rinovuar plotësisht. Nga ky ambient tashmë ishin hequr dollapët në të cilët personat zyrtarë i ruanin sendet e tyre dhe i

njëti përdoret vetëm për vizita me avokatët dhe familjet. Po ashtu, ishin larguar edhe grilat prej metali, ndërsa ambienti ishte adaptuar në atë mënyrë që ishte ngritur mur në të cilin ka hapje për komunikim të personave të privuar nga liria me familjet e tyre ose avokatin.

MPN-ja, gjatë vizitës për rikontroll, konstatoi se nuk ka ndryshime sa i përket shërbimit dhe konsumimit të ushqimit, më saktë personat e paraburgosur edhe më tej ushqimin e konsumojnë në ambientet e gjumit dhe në të cilat njëkohësisht i kryejnë nevojat higjienike dhe fiziologjike.

Në burg nuk ka mjek të punësuar, përkatësisht mjeku i cili ka qenë i punësuar, nga fundi i muajit shtator të këtij, viti ka shkuar në institucion tjetër shëndetësor, ndërkaq nuk ka infermiere të punësuar.

Në ambulancë ka vetëm byro dhe krevate mjekësore, ku kryhen vizitat, si dhe një element i veçantë në të cilin ruhet dokumentacioni shëndetësor i personave të dënuar, por i njëjti përbëhet vetëm nga raftet. Ende vihet në pikëpyetje konfidencialiteti i të dhënave të cilat i përmbajnë kartonët shëndetësorë, për shkak se në ambulancë nuk ka pjesë të mbyllur ku do të mund të ruheshin të njëjtët.

Gjatë kohës së vizitës për rikontroll, MPN-ja konstatoi se burgu mban evidencë për parashtrësia dhe libër për ankesa dhe kërkesa të personave të dënuar. MPN-ja zbatoi këqyrje në dy libra, me ç'rast konstatoi se të njëjtat udhëhiqen me rregull. Gjithashtu, Libri për ndëshkime disiplinore udhëhiqet me rregull, për muajin tetor kishte 3 ndëshkime disiplinore-dërgim në dhomë izolimi, çdo faqe e librit është e shkruar dhe e nënshkruar nga drejtori i Burgut. Në evidencën e njëjtë nuk u vërejt përdorimi i korrektorit.

Në Burgun Prilep ende nuk zbatohet procesi arsimor i cili në përputhje me LES duhet të organizohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kjo u konstatua edhe gjatë vizitës për rikontroll, sepse as brenda burgut e as jashtë tij nuk zhvillohet procesi arsimor. MPN-ja edhe më tej vë në pah se arsimi është njëri nga faktorët kryesor për risocializimin e suksesshëm i përcaktuar me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve. Në Burgun Prilep, gjatë kohës së vizitës, kishte tre persona të dënuar të cilët nuk e kishin kryer arsimin fillor.

Konstatimi që rezulton nga kjo vizitë është se rekomandimet e dhëna, në pjesën më të madhe janë zbatuar, një pjesë e tyre është zbatuar pjesërisht, por mbetet edhe një pjesë që nuk janë zbatuar, të cilat janë të kushtëzuara me implikime financiare. Njëkohësisht, një pjesë e rekomandimeve tashmë janë në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht, mbrojtja shëndetësore me ndryshimet e fundit ligjore, është në kompetencë të institucioneve shëndetësore.

Si rezultat i vizitës të rregullt të realizuar pa paralajmërim, Mekanizmi Parandalues Nacional përgatiti raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe INK Burgut Prilep.